



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8123

Tirane, date 15.12.2015

Drejtuar: Z.ARTAN KUQO
SHOQERIA "K - 12" SH.P.K
BULEVARDI "RESHIT ÇOLLAKU", VILA 24,

POGRADEC

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1022 date 13.06.2007.

I nderuar z. Kuqo,

Shoqëria "K - 12" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1022 date 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur ne objektin "Çervenakë", Pogradec, ne Qarkun Korçe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.8139 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1022 date 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur ne objektin "Çervenakë", Pogradec, ne Qarkun Korçe, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2012 – 2013 dhe vitin 2015 - 2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germen "ç" të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1022 date 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur në objektin "Çervenakë", Pogradec, në Qarkun Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1022 date 13.06.2007, për mineral hekur – nikel dhe nikel - hekur në objektin "Çervenakë", Pogradec, në Qarkun Korçë.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

